



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Datë: 14/11/2018 Nr.020-1260
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vitisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin e kuvendit të komunës si në vijim:

1. Vendimi 01-110/05-1131 për ndryshimin, plotësimin e Vendimit me nr. 01-110/05-1002, i datës 28.09.2018, vendimi për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale- parkingjet në qytetin e Vitisë
I miratuara më datë: 31.10.2018
I parashtruara për shqyrtim në MAPL më datë: 01.11.2018


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi*** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration



Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik Opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština- MALS	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 14.11.2018
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Vitina	Br.020-1260
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akata opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku.

1. Odluka 01-110/05-1131 za dopunu i izmenu Odluke br. 01-110/05-1002, od dana, 28.09.2018.godine, odluka za pokretanje postupaka za davanje na korišćenje opštinske imovine za gradska parkirališta u gradu Vitina
Usvojena dana, 31.10.2018. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 01.11.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi, i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

01-11-2018

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Vitina

01-110/05-1131

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, neni 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40. (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 5 dhe 6 të Statutit të Shpallur të Komunës së Vitisë dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Ligji Nr.04/L-144. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012). Rregullore QRK Nr. 23/2013 për caktimin e shfrytëzimit dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe neni 35, paragrafi 55.2, shkronja c, të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.01.2011, kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kërkesa me nr.020-1102/4, e datës 24.10.2018. Kuvendi i Komunës së Vitisë: në seancën e mbajtur më datën 31.10.2018, merr këtë:

Kuvendi për Dënimin në Komuna	
Opština Vitina	
Municipality of Vitina	
01-11-2018	
-v- 020-1260	

**V E N D I M**

Për ndryshimin, plotësimin e Vendimit me Nr.01-110/05-1002, i datës 28.09.2018, vendim për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë

**Neni 1**

Me këtë vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë, bënë ndryshim plotësimin e vendimit Nr. 01-110/05-1002, të datës 28.09.2018, vendim për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë. Me këtë vendim bëhet ndryshimi i emërimit të vendimit për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë në vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë të jep pëlqimin paraprak për fillimin e procedurave për shpalljen e ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dy vite (2 vite) pronën komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë, përkatësisht parcelat kadastrale me nr.2592-3, me sipërfaqe prej 102m<sup>2</sup>, nr.2592-4, me sipërfaqe prej 53m<sup>2</sup>, nr.2592-5, me sipërfaqe prej 96m<sup>2</sup>, nr.2592-6, me sipërfaqe prej 104m<sup>2</sup>, nr.2592-7 me sipërfaqe prej 156m<sup>2</sup>, nr.2592-8, me sipërfaqe prej 118m<sup>2</sup>, nr.2592-9, me sipërfaqe prej 104m<sup>2</sup>, nr.2592-10, me sipërfaqe prej 130m<sup>2</sup>, nr.3625-3, me sipërfaqe prej 209m<sup>2</sup>, nr.3625-4, me sipërfaqe prej 107m<sup>2</sup>, nr.3625-5, me sipërfaqe prej 348m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale në Vitë.

**Neni 2**

Ky vendim do të jetë pjesë plotësuese e vendimit Nr. 01-110/05-1002, i datës 28.09.2018, vendim për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë.

**Neni 3**

Të gjitha pjesët tjera të vendimit Nr. 01-110/05-1002, i datës 28.09.2018, vendim për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë, mbeten në fuqi.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të aktëve të Komunave, neni 16 i Rregullores (MAPI) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit e aktëve të komunës dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

- 1. Drejtorisë për Kadastër,
- 2. Drejtorisë për Shërbime Publike,
- 3. Shërbimit të Kuvendit, dhe
- 4. Arkivit.

KUVENDI KOMUNAL I VITISË  
KRYETARËSI

Saim Dina